



Leximi i Kuranit

## Description

Tarik Ramadan





Kurani është për myslimanët tekst referimi, burimi dhe thelbi i mesazhit që i është transmetuar njerëzimit nga Krijuesi. Është shpallja e fundit, prej shpalljeve të shumta që i janë sjellë njerëzimit përgjatë historisë. Ai është fjala e Zotit, por jo Zoti. Kurani bën të ditur, zbulon dhe udhëzon: është dritë që i jep përgjigje kërkimit për të gjetur kuptimin e ekzistencës. Kurani është përkujtim i të gjitha mesazheve të mëparshme, atyre të Nuhut, Ibrahimit, të Moisiut dhe Jezusit. Ai, ashtu si mesazhet e mëparshme, na përkujton dhe udhëzon ndërgjegjen tonë: jeta ka kuptim, ka fakte dhe shenja.

Ai është libri i të gjithë myslimanëve në të gjithë botën. Por, në mënyrë paradoksale nuk është libri i parë që duhet të lexojë ai që dëshiron të dijë më shumë për Islamin. Një libër për jetën e profetit, ose që e prezanton Islamin, do të ishte më i përshtatshëm, sepse Kurani është shumë i thjeshtë por njëkohësisht është dhe shumë i ndërlikuar. Natyra e mësimave shpirtërore, njerëzore, historike dhe sociale që mund të përftohen prej tij, mund të kuptohen në nivele të ndryshme. Teksti i shenjtë është një, por shpjegimet e tij janë të shumta.

Për gruan dhe burrin zemra e të cilëve e ka përvetësuar mesazhin e Islamit, Kurani është i qartë. Ai është edhe Zëri edhe Rruga. Zoti i flet qenies së tij, ndërgjegjes së tij, zemrës së tij dhe e udhëzon atë në rrugën që e shpie drejt njohjes së Tij, tek takimi me Të: **“Ky është libri që nuk ka dyshim në te (sepse është prej Allahut) është udhëzues për ata që janë të devotshëm”**. Më shumë se thjesht një tekst, Kurani është shok udhëtimi që duhet të lartësohet, të lexohet dhe të dëgjohet.

Në gjithë botën myslimane, nëpër xhami, shtëpi dhe nëpër rrugë, mund të dëgjosh zëra të mrekullueshëm që lexojnë fjalët hyjnore. Këtu nuk mund të ketë ndryshim ndërmjet dijetarëve fetarë (ulematë) dhe laikëve. Kurani i flet gjithsecilit me gjuhën e tij, që t'i përshtatet inteligjencës, zemrës, pyetjeve, kënaqësisë dhe dhimbjes së tij. Dijetarët e kanë emërtuar këtë lexim apo dëgjim, si adhurim. Ndërsa myslimanët lexojnë apo dëgjojnë tekstin e shenjtë, ata përipiqen ta mbushin shpirtin e tyre me dimensionin shpirtëror të mesazhit të tij; përtej kohës, përtej historisë dhe miliona qenieve që popullojnë tokën, Zoti i flet gjithsecilit prej tyre, duke i bërë thirrje dhe duke e përkujtuar secilin prej tyre, duke ftuar, duke udhëzuar, duke këshilluar dhe duke urdhëruar. Zoti i përgjigjet atij, asaj, zemrës së gjithsecilit: pa ndërmjetës, nëpërmjet një lidhjeje shumë të thellë.

Nuk është nevoja për studime, diploma, mësuës apo udhëzues. Këtu, ndërsa bëjmë hapin e parë, Zoti na thërret me thjeshtësinë e afërsisë së tij. Kurani i përket gjithkujt, pa dallime apo hierarki. Zoti i përgjigjet kujtdo që lexon fjalën e Tij. Nuk është e rrallë të shohësh gra dhe burra, të pasur dhe të varfër, të shkolluar dhe analfabetë, lindorë apo perëndimorë të rënë në heshtje, që vështrojnë në largësi, humbasin në mendime apo qajnë. Kërkimi i tij për të vërtetën është përballur me të shenjtën, Zoti është afër: **“Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet”**.

Një dialog ka filluar. Një dialog i gjallë, i përhershëm, ndërmjet një Libri që tregon thjeshtësinë e pafundme të adhurimit të Zotit, dhe zemrës që bën përpjekjen e fortë që është e nevojshme për të çliruar veten. Në qendër të çdo përpjekjeje të zemrës gjendet Kurani. Ai ofron paqe dhe të shpie drejt

---

Page 4  
lirisë.

**Date Created**

16/10/2014

**Author**

erasmusi